



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1056 Prot.

Durrës, më 5.6.2024

VENDIM

Nr. 43, datë 5.6.2024

PËR

"MIRATIMIN PARAPRAK PËR NJË SHITESË NË RREGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË PROÇEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN KALENDARIK 2024"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të UAMD-së, të Rregullores së UAMD-së, të shkresës nr.930/1 prot., datë 04.06.2024 të Administratorit, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin paraparak për një shtesë në rregjistrin e parashikimit të proçedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2024, sipas relacionit të Administratorit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
ADMINISTRATORI

Senat Akademik

Nr. 930/A Prot.

Durrës, më 04.06.2024

Lënda: **KËRKESË PËR NJË SHITESË NË RREGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN KALENDARIK 2024.**

Drejtuar: **SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**

KËTU

Të nderuar,

Ju bëj me dije se, me shkresën Nr. 930 Prot datë 15.05.2024, është paraqitur nga ana e koordinatorit të projektit të Ndërkombëtarizimit me objekt : "Diplomë e dyfishtë në Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor "Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatike kërkesa për blerjen e librave (*bashkëlidhur*).

Bazuar në Kontratën e financimit me Nr.1868/2Prot., datë 20.10.2023 (*bashkëlidhur*), si dhe referuar buxhetit të parashikuar për projektin e Ndërkombëtarizimit me objekt:"Diplomë e dyfishtë në Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor "Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatike, që Universiteti Aleksandër Moisiu është duke implementuar në partneritet me Universitetin e Genova (Itali), është përcaktuar nevoja për blerje librash, sipas kërkesës së sipërcituar.

Sa më sipër, në kuadër të marrëveshjes së lidhur midis Universitetit të Genovës dhe Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës, si dhe me qëllim realizimin e projektit, konsiderohet e nevojshme të shtohet si element në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2024, procedura e prokurimit me objekt : "Blerje libra në kuadër të projektit të Ndërkombëtarizimit"Diplomë e dyfishtë në Ciklin e Parë të Studimeve Bachelor "Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomatike me burim financimi nga fondet e parashikuara të projektit me vlerë prej 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa Tvsh, duke respektuar dispozitat ligjore kombëtare të parashikuara në legjislacionin dhe rregullat në fuqi të prokurimit publik.

Duke iu falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

ADMINISTRATOR

GERALD ÇEKA